

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Perëndimor të Timisoara, në Rumani

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete për degën e Gazetarisë në Universitetin Perëndimor të Timisoara, në Rumani, në kuadër të programit Erasmus +.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie (*në degën e Gazetarisë*)

Kohëzgjatja e bursave:

- Staf Akademik për Mësimdhënie 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze)
- Kopje e pasaportës
- Letër motivimi (në gjuhën angleze)
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe)
- Certifikata e gjuhës së huaj

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie

**Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyri gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Afati për aplikime: 28 Shkurt 2018

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!